



## **PËLQIM PËR DHËNIEN, RUAJTJEN, PROCESIMIN DHE TRANSFERIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Me vullnetin tim të lirë jap pëlqimin shprehimor që Sigma Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë (me tutje referuar edhe si "Kompania") të marrë, ruajë, përpunojë, procesojë dhe transferojë të dhënat e mia personale dhe të dhënat e ndjeshme personale (biometrike, gjenetike, shëndetësore) në formë elektronike dhe/ose të shtypur për qëllimet e specifikuar më poshtë:

- për aplikimet e mia për të gjitha shërbimet apo produktet e sigurimit;
- për të gjithë procesin e shitjes dhe marrjes në sigurim, si dhe lëshimin e policës/ave të sigurimit dhe menaxhim të policave të mia të sigurimit;
- për vlerësim dhe trajtim të kërkesave për dëmshpërblim, ku mund edhe të kërkojë dhe të marrë informacion lidhur më të dhënat e mia personale apo të ndjeshme personale të nevojshme për trajtimin e kërkesave të mia për dëmshpërblim nga palë të treta që disponojnë këto të dhëna si p.sh. institucione mjekësore/shëndetësore, kompani të tjera sigurimesh, kompani të ndryshme shërbimesh dhe asistence si vlerësues të licencuar për ekspertiza dhe të tjera;
- për vlerësim dhe trajtimin të çfarëdo kërkesë tjetër;
- për të kryer marketing të drejtpërdrejtë për produktet dhe shërbimet e Kompanisë;
- për të më kontaktuar përmes postës, telefonit, SMS-ve, postës elektronike ose mjete të tjera, në përputhje me udhëzimet e mia të dhëna në Kompani.

Gjithashtu, konfirmoj se unë jam informuar dhe udhëzuar që Kompania do të mbledhë, ruajë dhe përpunojë të dhënat e mia personale në formë elektronike dhe/ose të shtypur vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe vetëm për kohëzgjatjen e kërkuar me legjislacionin përkatës në fuqi.

Unë jam informuar për të drejtat e mia në lidhje me të dhënat e mia personale, siç është e drejta: që të njihem me të dhënat personale dhe të dhëna të ndjeshme personale (biometrike, gjenetike, shëndetësore); për qasje në të dhënat e mia personale; për të korrigjuar, ndryshuar dhe/apo fshirë të dhënat e mia personale; për të kufizuar përpunimin; të njoftohem për shkelje të të dhënave të mia personale; për transferimin e të dhënave; për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave personale ose për të rregulluar vendimmarrjen e automatizuar nga Kompania; të paraqesë një ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësisë; për të tërhequr pëlqimin tim në çdo kohë.

Po ashtu, autorizoj Kompaninë që të transferojë të dhënat e mia personale tek palët e treta që kërkohen ose nevojiten për ekzekutimin e transaksionit ligjor të kontraktuar ose të rënë dakord midis meje dhe Kompanisë, duke përfshirë por duke mos u kufizuar ndonjë anëtar të Grupit Vienna Insurance Group, ndonjë pale të tretë, si dhe kompanie dhe/ose institucioni tjetër, përfshirë në vende të treta, në përputhje me ligjet në fuqi.

Unë gjithashtu jam informuar se Kompania ka zyrtarin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe se jam udhëzuar që çdo çështje e shqetësim timin lidhur me të dhënat personale mund ta adresoj në çdo kohë përmes adresës elektronike: [mbrojtjaetedhenavepersonale@sigma-ks.net](mailto:mbrojtjaetedhenavepersonale@sigma-ks.net)

Deklaroj se jam i vetëdijshëm për faktin se e drejta e tërheqjes nga ky pëlqim nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit të kryer në bazë të pëlqimit të dhënë para tërheqjes së tij.

Me nënshkrimin e këtij dokumenti, unë e konfirmoj që e kam lexuar dhe kuptuar tërësisht pëlqimin tim të lartshënuar që është i qartë, i dallueshëm, i kuptueshëm dhe vullnetarisht e autorizoj Sigma Vienna Insurance Group SH.A. Dega Kosovë (Kompaninë) për të mbledhur, ruajtur, përpunuar dhe bartur të dhënat e mia personale, siç është paraparë më lart në këtë pëlqim dhe në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_, Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Nr. Personal në dok. identifikues: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_ Vendi: \_\_\_\_\_